

TERMAT E REFERENCËS:

Në hartimin e termave të referencës grupi i punës u mbështet në V.K.M Nr. 354, datë 11.05.2016 “PËR MIRATIMIN E MANUALIT TË TARIFAVE PËR SHËRBIME NË PLANIFIKIM TERRITORI, PROJEKTIM, MBIKQYRJE DHE KOLAUDIM”.

Godina që do t’i bëhet rirforcimi në këtë investim janë:

PALLATI NR 1047 (ARVI) RRUGA TAULANTIA GIS 27498

PALLATI ARVI (GIS 27498), RRUGA "TAULANTIA"



Vendodhja e Objektivit

Objekti ndodhet ne rrugen "Taulantia", "Bashkia DURRES" gjeresi dhe gjatesi gjeografike 41.310713 N dhe 19.443360 E sikurse tregohet edhe ne pamjet e mesiperme.

Në bazë të Udhëzimit Nr.1, datë 16.06.2011, “Për disa ndryshime në udhëzimin Nr.3, datë 15.02.2001, të Këshillit të Ministrave, “Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar:

Mbikqyrja e punimeve kryhet nga persona fizikë dhe juridikë të paisur me certifikatë personale përkatëse. Mbikqyrja e punimeve për objekte që ndërtohen me financim publik, emërohet nga investori pas zgjedhjes me prokurim në përputhje me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Koha e mbikqyrjes së punimeve lidhet me kohën e zgjatjes së punimeve dhe fillon nga data e lidhjes së kontratës me firmën zbatuese.

Në përfundim të punës mbikqyrësi i punimeve dorëzon me proces verbal te investitori dokumentacionin teknik të mbajtur gjatë zbatimit të punimeve.

Grupi i Specifikimeve Teknike